

Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës

Në përputhje me autorizimin që është dhënë sipas nenit 17.b të Rregullores së UNMIK-ut 2001/24 të datës 1 Tetor 2001 mbi ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/20 mbi Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor 2001 mbi licensimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e Kompanive dhe të ndërmjetësuesve të sigurimit,

Me qëllim të zbatimit të nenit 13 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25,

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 Mars 2002, miratoi:

Regulli 5 C mbi licensimin e Ndërmjetësuesve të risigurimit (Ndërmjetësuesve të Sigurimeve)

Neni 1

Marrja e Pëlqimit për Licencë të Ndërmjetësuesit të Sigurimeve

1. Shtrirja e rregullit

Ky rregull aplikohet për të gjithë aplikuesit që kërkojnë të merren me biznesin e ndërmjetësuesit të risigurimit.

2. Definicioni i termeve:

Në këtë Rregull termet në vijim kanë domethënie:

“Aktuari” do të ketë domethënieën sic është definuar në Kapitullin I, Neni 1 I Rregullores së sigurimit.

“Siguruesi” është një kompani e sigurimit e licensuar siq duhet nga BPK-ja.

“I Licensuari” është personi i licensuar nga BPK-ja sipas këtij rregulli.

“Personi” përfshinë çfarëdo individ, firmë, kompani, shoqatë, organizatë partnership dhe korporatë.

“Risigurim” do të ketë kuptimin e definuar sipas Kapitullit I, Neni 1 të Rregullores së sigurimit.

“Ndërmjetësues i Risigurimit” përfshinë brokerin e risigurimit dhe përfaqësuesin e risigurimit.

“Brokëri i risigurimit” apo shkurt “BR” është personi i cili nuk është nëpunës apo punëtor i siguruesit cedues (kalues), që ndihmon, negocion apo vendosë cesionet (kalimet) apo retrocesionet siguroese në emër të siguruesit cedues (kalues) pa autoritet për të lidhur risigurim në emër të siguruesit cedues.

“Përfaqësuesi i risigurimit” apo shkurt “PR” është personi i cili ka autoritet për të lidhur biznesin e pranuar të risigurimit në emër të risiguruesit dhe i cili vepron si agjent i atij risiguruesi, qoftë i njohur si PR, menaxher lokal apo me terma tjerë të ngjashëm.

“Risiguruesi” do të thotë një kompani e risigurimit siq definohet me Kapitullin I, Neni 1 të Rregullores së sigurimit.

3. Marrja e Pëlqimit për Licencë të Ndërmjetësuesit të Sigurimeve

- a. **Të përshtatshëm dhe të duhur:** Njëra nga kërkesat kryesore për themelimin e operacionit të ndërmjetësuesit të sigurimeve është që brokëri i linjave tepicë apo aksionarët (nese aplikohet), drejtoret (nese aplikohet) dhe menaxheret e larte te jene “te pershtatshem dhe te duhur” qe te ushtrojne pergjegjsite e tyre. Prandaj ne rast se BPK me pas zbulon se ndonje aspekt i informatave te dhena ne lidhje me aplikacionin per licence te ndermjetsuesit te sigurimeve eshte falsifikuar me qellim, aksionaret (nese aplikohet), drejtoret (nese aplikohet) dhe menaxheret e larte do te denohen. Aplikacionet pezull automatikisht do te refuzohen ne kete rast. Ne rastet kur licenca eshte leshuar ne baza te informatave te falsifikuara, licenca per ndermjetsues te sigurimeve mund te terheqet menjehere.
- b. **Akuzat Kriminale:** Aplikantët për të cilët mësohet që kanë qenë të përfshirë në ndonjë aktivitet i cili ka rezultuar me akuza kriminale, të kaluara apo pezull, automatikisht do të diskualifikohen nga konsideratat e metejshme. Ky diskualifikim do të aplikohet për aplikuesit e tanishëm dhe për aplikuesit e ardhshëm për licence të ndërmjetësuesit të sigurimeve, deri sa një gjykatë kompetente Kosovare me autoritet i liron nga akuza.

- c. **Bankrotimi:** Personat që janë deklaruar të bankrotuar nga ndonjë gjyq me autoritet në Kosovë apo diku tjetër janë të diskualifikuar nga konsideratat e metejshme. Në mënyrë të ngjajshme, personat që kanë shërbyer si aksionare, drejtor apo menaxher në ndërmarrjet afariste të bankrotuara gjithashtu do të diskualifikohen nga konsideratat e metutjeshme.

4. Kërkesat për Kualifikim të Ndërmjetsuesve të Sigurimeve

Për të shërbyer ndërmjetësues I risigurimit, I licensuari duhet të ketë licensë valide të ndërmjetësuesit të sigurimit të lëshuar nga BPK-ja si një agjent për klasën e sigurimit që ai apo ajo dëshiron të udhëheqë biznesin e risigurimit.

5. Kërkesat për të gjithë aplikantët:

- a. **Informatat shtesë:** BPK ka të drejtën që në çdo kohë të kërkojë informata shtesë apo plotësuese në lidhje me ato që kërkojnë këtu, apo kohë pas kohe të përshkruajë shkallën minimale të njohurive teknike dhe aftësive të kërkuara për të licensuarin.

- b. **Gjuha:** të gjitha aplikacionet duhet të dorzohen në Shqip dhe/apo Serbisht apo Anglisht.

- c. **Provizioni për aplikacion:**

Një aplikant për licensë për të punuar si ndërmjetësues I risigurimit duhet të paguaj provizionin e aplikacionit prej 500 € i cila nuk kthehet. Ky provision paguhet përveq provizionit I cili aplikohet për agjent apo broker të sigurimit.

Të gjithë personat të cilët kërkojnë, negociojnë apo blejnë risigurim, dhe/apo menaxherët e një të licensuari duhet të jenë të licensuar si ndërmjetësues të risigurimit.

Aplikantët për licensë të korporatës duhet të paguaj provizionin e aplikacionit prej 500 €. Ky provizion është I veçantë dhe I ndarë nga provizioni për aplikacion që kërkojnë për aplikantët individual.

- d. **Të gjithë aplikantët duhet të sigurojnë këto të dhëna:**

d.1. Aplikacioni formal për të vazhduar afarizmin e ndërmjetsimit të sigurimeve të përgjithshme apo afarizmin e sigurimit jetsor në formatin e ofruar nga BPK.

- d.2. Organogrami origjinal apo dokumentacioni ekuivalent per kompanine e ndermjetsuese te sigurimeve te propozuar se bashku me statusin e kompanise apo dokumentacionin ekuivalent (nese aplikohet);
- d.3. Curriculum Vitae (Biografite-CV-te) e plota dhe te detajuara te ndermjetsuesit apo aksionaret kryesor (kur ata mbajne ose do te mbajne me shume se 10% te aksioneve te paguara), nese aplikohet, drejtoret (nese aplikohet) menaxheret e larte te propozuar per ndermjetsues te sigurimeve. CV-te duhet te permbajne historine profesionale te tyre dhe pergatitjet e tyre akademike. CV-te e ndermjetsuesve apo te menaxhereve te larte te propozuar duhet te demonstrojne eksperience te konsiderueshme ne industrine e sigurimeve, trajnim dhe dije. Qarte, kjo do te thote qe menaxheri I larte I propozuar zakonisht duhet te kete diplome te pranuar ne biznes nga nje institucion akademik te respektuar dhe/apo kualifikime te pranuar nga industria e sigurimeve dhe/apo pervaqe te konsiderueshme profesionale ne sigurime. Kualifikimet origjinale akademike dhe profesionale duhet t'i dorzohen BPK-se per shqyrtim. BPK do te ndermerr hetimet e veta per prapavine e aplikantit si dhe letrat kredenciale;
- d.4. Lista me te gjitha individet, me adresat e tyre dhe nacionalitetet, te cilet jane/do te jene aksionaret kryesor te regjistruar (sic eshte e definuar me larte) apo pronaret e fundit te cilet perfitojne nga kompania per ndermjetsime ne sigurime. Kjo liste duhet te perfshije edhe aksionet e secilit aksionar kryesor;
- d.5. Gjendja e bilancit personal/raportet mbi burimet e resurseve financiare te vertetuara dhe complete per ndermjetsuesin apo aksionarin kryesor (nese aplikohet), drejtorin (nese aplikohet) dhe menaxheret e larte te propozuar per ndermjetsime ne sigurime. Nje banke apo firme e revizionit e pranuar nga BPK-ja duhet ti vetretoje raportet. Cdo perjashtim duhet te aprovohet nga BPK-ja.
- d.6. Tri referenca profesionale per ndermjetsuesin apo per secilin aksionar individual (nese aplikohet), drejtoret (nese aplikohet) dhe menaxheret e larte per operacionin e propozuar te ndermjetsimit ne sigurime. Nje banke apo firme e revizionit e pranuar nga BPK-ja e cila ka vertetuar raportet e burimeve financiare te siper-permendura duhet te ofroje njeren nga referencat.

- d.7. Një dokument në lidhje me kategorinë apo kategoritë e sigurimit për të cilat aplikanti dëshiron të licensohet.
- d.8. Lista e individëve të punësuar nga ndermjetuesi apo ushtruesve të detyrës së ndermjetuesit të sigurimeve me dokumentet autoritative që tregojnë për kualifikimet e tyre profesionale dhe akademike;
- d.9. Kontrata e qirase me qiradhenesin që verteton vendin e biznesit ku shkresat formale ligjore mund të dorzohen;
- d.10. Kopja origjinale e në lidhje me demshperblimin të propozuar për sigurim.
- d.11. Kopja origjinale e letres me vlerë (surety bond), apo certifikata e depozitit në lidhje me surety bond, në formën dhe shumën e kërkuar sipas këtyre rregullave.
- d.12. Ndryshimet e rëndësishme planit të biznesit të dorzuar nga aplikanti duhet të miratohen nga BPK. Një rregull tjetër i BPK-së për sigurime nënvizon se BPK çfarë konsideron të jetë ndërrim i rëndësishëm. Mospërmbushja e këtyre kërkesave do të rezultojë në sanksione të përshkruara në Rregulloren Kosovare mbi sigurimet apo në rregullat e BPK-së.

6. Kualifikimet edukative dhe përvoja për ndermjetues të sigurimeve

Personi i licensuar nga BPK-ja si agjent apo broker mund të kualifikohet për licencë të ndermjetuesit të risigurimeve pa edukimin dhe eksperiencën e duhur duke i dhënë BPK-së se posedon njohuritë dhe aftësitë e duhura për të marrur në linjë tepricë të sigurimit. Një dokumenti të verifikuar të përvojës së mëparshme apo të tanishme në prokurimin dhe lëshimin e linjave tepricë apo biznesin e risigurimit do të jetë i rëndësishëm dhe konsiderueshëm.

Sipas gjykimit të vet, BPK-ja mund të kërkojë nga aplikanti të demonstrojë aftësitë e tij teknike si një broker i linjave tepricë të sigurimit si kusht për lëshimin apo mbajtjen e licensës së tij apo saj.

Neni 2

Kerkesat per Aplikantet qe Deshirojne te Operojne nepermes Ndremjetsuesve te Sigurimeve te inkorporuar ne Kosovë

1. Kapitali Minimal

Nje minimum I paguar I kapitalit jo me pak se 25,000 € kerkohet per kompani te inkorporuar ndermjetsuese te risigurimeve. BPK do te kerkoje nje certificate nga nje banke e autorizuar nga BPK-ja qe te vertetoje se kapitali eshte paguar apo investimi eshte bere ne llogarine e ndermjetsuesit, sido qe te jete.

Per aplikantet e inkorporuar jashte Kosoves qe deshirojne te themelojne operacione ndihmëse ne Kosove, BPK do te kerkoje nje leter nga mbikqyresi I ndermjetsuesve te risigurimeve ne vendin I origjines qe mbikqyresi është I informuar dhe ne pajtim me qellimin e aplikantit te themeloje operacion per ndermjetsime ne sigurime ne Kosove. Ne leter duhet te ceket qe aplikanti I permbahet ligjeve te sigrimeve ne vendin e origjines duke perfshire edhe kerkesat ne lidhje me aftesite paguese.

2. Aplikanti jasht Kosoves qe deshiron te inkorporohet

Aplikanti jasht Kosoves qe deshiron te inkorporoje nje kompani ndihmese per ndermjetsime ne risigurime duhet te dorzoje pasqyrat financiare vjetore te kontrolluara per pese vitet e fundit ne Shqip dhe/ose Serbisht apo Anglisht (nje perkthim I vertetuar ne Anglisht eshte I pranueshem). Kur aplikohet, llogarite vjetore per pese vitet e fundit te kompanise meme te aplikantit dhe te kompanive tjera qe kane lidhje me te duhet te dorzohen ne te njejtin format te gjuhes.

Pritet qe aplikantit te kete pasur profit se paku gjate kater viteve ne pese vitet e fundit.

2. Licensa për korporatë

- a) Një ndërmjetësuesi të inkorporuar të organizuar siq duhet mund ti jipet licensa e korporates si një ndërmjetësues I risigurimit.
- b) Licensa e korporatës duhet ti përfshijë ne listë të gjithë individët në korporatë të cilët I kanë plotësuar të gjitha kërkesat dhe janë licensuar sipas këtij rregulli si ndërmjetësues I risigurimit.
- c) Vetëm ata individë të cilët ndodhen në listen e licensës së korporatës duhet të merren me biznesin e ndërmjetësuesve të risigurimit.

3. Firma Revizore

Firma e propozuar dhe e licencuar e revizionit per ndermjetsuesin e sigurimeve te propozuar duhet te aprovet nga BPK-ja. Qarte, kjo do te thote qe BPK-ja pranon firmen e licencuar per revizion si te afte per te siguruar ekspertizen e duhur ne industrine e sigurimin.

Neni 3

Kerkesat per Aplikantet qe deshirojne te operojne si dege brenda Kosoves

1. Deklarata nga Mbikqyresi ne jurisdikcionin e brendshem

Për aplikantet e inkuorporuar jashte Kosoves qe deshirojne te themelojne nje dege operuese ne Kosove, BPK do te kerkoje nje leter nga mbikqyresi I ndermjetsuesve te risigurimeve ne vendin meme qe tregon se mbikqyresi është I informuar dhe pajtohet me qellimin e aplikantit te themeloje operacion per ndermjetsime ne risigurime ne Kosove. Ne leter duhet te ceket qe aplikanti I permbahet ligjeve te sigrimeve ne vendin e origjines duke perfshire edhe kerkesat ne lidhje me aftesite paguese.

2. Raportet Financiare

Nje aplikant jasht Kosove qe deshiron te operoje me nje dege te kompanise per ndermjetsime te risigurimeve duhet te dorzoje pasqyrat financiare vjetore te kontrolluara per pese vitet e fundit ne Shqip dhe/ose Serbisht apo Anglisht (nje perkthim I vertetuar ne Anglisht eshte I pranueshem). Kur aplikohet, llogarite vjetore per pese vitet e fundit te kompanise meme te aplikantit dhe te kompanive tjera qe kane lidhje me te duhet te dorzohen ne te njejtin format te gjuhes.

Pritet qe aplikantit te kete pasur profit se paku gjate kater viteve ne pese vitet e fundit.

3. Firma Revizore

Firma e propozuar dhe e licencuar e revizionit per ndermjetsuesin e sigurimeve te propozuar duhet te aprovet nga BPK-ja. Qarte, kjo do te thote qe BPK-ja pranon firmen e licencuar per revision si te afte per te siguruar ekspertizen e duhur ne industrine e sigurimin.

Neni 4

Kushtet e Pandashme per Licensimin e ndërmjetësues I risigurimit

1. Kerkesat per Licensim

Asnje person nuk do te angazhohet ne biznesin e rregulluar ne kete rregull, apo te pretendoj te veproj si i licensuar, perveq nese ai po ajo eshte e licensuar ne baze te kesaj rregulle.

2. Kualifikimi I Menaxhereve

Asnje person nuk duhet te veproj si menaxher I ndermjetesuesve perveq nese ai apo ajo posedojn licensen per ndermjetesues te risigurimeve te leshuar ne baze te kesaj rregulle dhe te kete demonstruar BPK-s se ai teknikisht dhe profesionalisht eshte I kualifikuar te drejtoj, kontrolloj dhe te menaxhoj biznesin e ndermjetesuesit.

3. Informimet

Ndermjetesuesi I licensuar duhet ta informoj BPK-n, Brenda 30 diteve nga zhvillimi i ngjarjeve dhe kushteve te cilat vijoje:

- a) Menaxheri I tij apo saj pushon së qenuri I lidhur me ndermjetesuesin.
- b) Caktimi dhe kualifikimi I menaxherit te ri apo menxherit shtese te ndermjetesuesit.
- c) Cdo ndryshim I emrit, perberjes apo adreses se ndermjetesuesit, apo aksionarve kryesor (kur ata posedojn me shume se 10% te aksioneve te paguara), nese eshte e mundur, drejtoret dhe menaxheret e ndermjetesuesit.
- d) Nëse dëmi ka mundësi që të tejkalojë shumën e vendosur nga risiguruesi.
- e) Nëse dëmi është rregulluar për më pak se shuma e vendosur nga risiguruesi.
- f) Nëse dëmi mbetet I hapur për një periudhë më shumë se 6 muaj.

4. Mos-transferi I Licenses

Nje license e leshuar ne baze te kesaj rregulle eshte personale dhe ekskluzivisht e individit te licensuar dhe nuk eshte e transferueshme (nuk mund te transferohet).

5. Aprovimi I kontratës së shkruar

I licensuari duhet që sa më shpejt që është e mundur, të dërgojë në BPK kontratën me shkrim apo marrëveshjen që ai apo ajo ka bërë me sigurues të licensuar (aplikohet për ndërmjetësues –broker të risigurimit) apo me kompani të risigurimit (aplikohet për ndërmjetësues –përfaqësues të risigurimit) për aprovim.

Kontrata apo marrëveshja duet të specifikojë së paku, detyrat, përgjegjesitë dhe autoritetet e të licensuarit, mënyra me të cilën I licensuari do të ofrojë llogaritë e tij, dërgimin e fondeve so dhe autoritetin e BPK-së për të gjykuar kontestet që dalin nga performanca e obligimeve përkatëse të palëve sipas kontratës apo marrëveshjes së tyre.

6. Përgjegjësia e matur

I licensuari duhet te siguroj se risigurimi është I vendosur vetem me sigurues apo risigurues që kan kushte te shendosha financiare dhe me reputacion te mire nderkombetare. I licensuari duhet te kete ne dosjen e tij nje kopje te certificates se kompanisë risigruuese te tanishem, ne formë te mire, te leshuar nga autoriteti I mbikqyrës I vendit të kompanisë risigruuese që pohon se risigruesi I tille eshte ne gjendje te mire dhe ne pajtim me kerkesen per minimumin e kapitalit dhe teprices, te pershkruar nga ai autoritet.

7. Veprimet e ndaluara

Asnje person I licensuar ne baze te kesaj rregulle, drejtori I saj, zyrtaret, menaxheret apo te punesuarit, nuk duhet te bejne me sa vijon:

- a. Të bëje biznes të autorizuar me këtë rregull para se BPK-ja të aprovojë kontratën apo marrëveshjen në mes të ndërmjetësuesit të risigurimit dhe kompanisë së sigurimit (në lidhje me brokerin e risigurimit) apo me kompani (të) risigruuese (në lidhje me përfaqësuesin e risigurimit)
- b. Të emëroj nën-broker apo nën-përfaqësues.
- c. Të emëroj nën-agjentë I cili nuk është I licesuar për të bërë llojin e risigurimit për të cilin agjenti apo nën-agjenti është I emëruar.

8. Mbajtja e shenimeve

Cdo ndërmjetësues I risigurimit I licensuar duhet te mbaje ne zyren e tij apo saj te lokalizuar ne Kosove, shenime te plota dhe te verteta te secilit transaksion të risigurimit qe tregon informatat te cilat vijojne:

- a) Lloji I kontratës, limitet, restriksionet e marrjes në sigurim, kategoritë apo rreziku dhe territori.
- b) Periudha e mbulesës, datat efektive dhe të skadimit, dispozitat e anulimit, dhe njoftimi I kërkuar për anulim.
- c) Raportimi dhe vendosja e bilanceve.
- d) Normat e përdorura për të kalkuluar premiumin e risigurimit
- e) Emrat dhe adresat e risiguruesve
- f) Normat për të gjitha komisionet
- g) Emrat dhe adresat e kompanive ceduese (kaluese)
- h) Korrespondenca dhe memorandumet përkatëse
- i) Dëshmia e vendosjes
- j) Shënimet financiare duke përfshirë por jo të limituara llogaritë e primeve dhe dëmeve.
- k) Ndonje kerkese shtese qe mund te kerkohet nga BPK-ja.

9. Raporti vjetor

Me apo para 1 Prillit te cdo viti, brokeri I licensuar I linjes se teprices duhet ti paraqes BPK-s nje raport te verifikuar te te gjithë biznesit të risigurimit të kryer gjatë gjate vitit paraprak kalendarik dhe ne forme te pershkruar dhe te pajisur nga BPK-ja duke indikuar me sa vijon:

- d. Shumen bruto te premive per cdo klase te rrezikut të risiguar.
- e. Llogaritë e dëmeve për cdo klasë të rrezikut të risiguar, të ndodhura, të rregulluara dhe pezull.
- f. Totalin bruto te premive te ngarkuara.
- g. Totali I llogarive të dëmeve.
- h. Rezerva e kërkuar dhe e ofruar për dëmet, nësa ka ndonjë, për secilin rrezik të risiguar.

- i. Vërtetimi aktuariel për totalin e reserves së kërkuar dhe të orfuar për dëmet, nëse ka ndonjë.
- j. Te gjitha informatat tjera te kerkuara nga BPK-ja.

Neni 5

Revokimi I licenses se ndermjetesuesit te sigurimeve

Kur licensa eshte dhene njeher nga BPK-ja, ndermjetesuesi I risigurimeve duhet te siguroj se ai vazhdon ti permbahet kushteve te dhena aty. Nese BPK-ja zbulon se nje nga faktoret qe formon nje pjese integrale te aplikacionit te ndermjetesuesit te risigurimeve eshte modifikuar pa lejimin paraprak te BPK-s, BPK-ja e ka te drejten qe menjeher te revokoj licensen e ndermjetesuesit te risigurimeve.

Revokimi po ashtu mund te ndodhe kur ndermjetesuesi I risigurimeve I posalicensuar, ne menyre serioze I kundervihet rregullores se sigurimeve te Kosoves apo rregullave te nxjerra nga BPK-ja. Ne menyre te ngjashme, cdo thyerje ligjit penal te nxjerre nga ndonje autoritet qeveritar apo trup kuazi-qeveritar (kuazi = jo I plote) ne Kosove mund te shpiej ne revokim te licenses.

Kur nje ndermjetesues I risigurimeve nuk e ka filluar aktivitetin brenda gjashte muajve nga marrja e licenses, BPK-ja automatikisht e revokon ate license.

Neni 6

Hyrja ne Fuqi

Ky rregull hyne ne fuqi me 1 Prill, 2002.

David Weatherman
Ushtrues I detyres se Drejtorit Gjeneral